



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 14.02.2025 | Nr: 93 | Ora: 12:00

VENDIM

**PËR FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE BAZUAR NË
DENONCIMIN NR. 13, DATË 12.02.2025, TË REGJISTRIT TË DENONCIMEVE,
TË KOALICIONIT PËR REFORMA, INTEGRIM DHE INSTITUCIONE TË
KONSOLIDUARA/KRIIK**

Sot më datë 14.02.2025, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi mori në shqyrtim paraprak denoncimin me:

KËRKUES: Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara/ KRIIK

SUBJEKT: Z. Alteo Hysi
Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë për Media dhe Informim

Z. Skënder Gjinushi
Kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë

Zj. Enkela Dudushi
Drejtor i Departamentit të Administratës Publike

OBJEKT: Përdorimi në postimet e aktiviteteve institucionale të disa Institucioneve të varësisë së Këshillit të Ministrave të sloganeve/hashtag-eve partiakë/elektoralë

BAZA LIGJORE: Neni 91, pikat 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 8, pika 3, të Vendimit nr. 9, datë 09.03.2021, të Komisionit Rregullator

KONSTATOJ:



Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK), më datë 12.02.2025, ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nëpërmjet adresës së postës elektronike e-mail, denoncimin e administruar në regjistrin e denoncimeve me nr. 13 ID.

Në këtë denoncim KRIIK parashtron sa vijon:

“Përgjatë gjithë periudhës parazgjedhore, në faqet zyrtare në “Facebook” të disa Institucioneve të varësisë së Këshillit të Ministrave janë duke u përdorur slogane elektorale të Partisë Socialiste, në formën e hashtag-eve.

Këto slogane është vërejtur se i përmban Faqja Zyrtare, e Institucione në varësi të Këshillit të Ministrave si:

- 1. Agjencia për Media dhe Informim;*
- 2. Akademia e Shkencave të Shqipërisë;*
- 3. Departamenti i Administratës Publike”.*

Nga sa më sipër çmoj se, ekzistojnë kushtet për t’u nisur hetimi administrativ.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 8, pika 3, të Vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve,

V E N D O S:

- Fillimin e procedurës administrative ndaj:
 - Z. Alteo Hysi, Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë për Media dhe Informim;
 - Z. Skënder Gjinushi, Kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë;
 - Zj. Enkela Dudushi, Drejtor i Departamentit të Administratës Publike.
- Rezultatet e këtij Vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet adresës së postës elektronike.
- Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI